ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**214-22-12927-1-1-1**
Nr i brendshëm	**214-22-121-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **"Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

TSR sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr Agim Ramadani A3 kati 4, nr 36
(Adresa)

Prishtine — **10000**
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044/517428 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Marksim Malsiaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@tsr-ks.com
(Adresa elektronike)

27.03.2023 — _____
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Me datën 8.12.2022 është publikuar njoftimi për kontrate.
- Me datën 5.01.2023 është publikuar njoftimi për korrigjim te gabimeve

-Afati i dorëzimit te ofertave, deri me datën 20.01.2023 koha 13:30:00 vendi Rr.Luan Haradinaj" p/n, Ndërtesa e re e MPB-së, kati II, zyra 204

- Hapja e ofertave po te njëjtën date: 15.02.2019 koha 14:00:00 vendi Rr.Luan Haradinaj" p/n, Ndërtesa e re e MPB-së, kati II, zyra 204
- Me datën 9.03.2023 përmes platformës se E-prokurimit kemi marre njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku Autoriteti Kontraktues ka marr vendim për te bere anulimin e tenderit me arsyen se nuk ka asnjë oferte te përgjegjshme.

-Kriter për dhënie te kontratës ka qen tenderi i përgjegjshëm me çmim me te ulte.

-Kërkesa për rishqyrtim me dt. 14.03.2023

-Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i dt.21.03.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Nuk na lejohet gjate prezencës ton te behet shikimi i Mostrave te OE
Përmes platformës se E-prokurimit kemi pranuar procesverbalin e hapjes se tenderëve.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së: Neni 7 Qëllimi
Neni 7 i LPP-së: Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 10 i LPP-së: Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 11 i LPP-së: Informatat Sekrete Afariste
Neni 59 i LPP-së: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.
Neni 60 i LPP-së: Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 62 i LPP-së: Përfundimi i aktivitetit të prokurimit
Neni 69 i LPP-së: Aftësia teknike dhe profesionale.
Neni 37: RREG 001/2022- Mostrat e Tenderëve
Neni 40: RREG 001/2022- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 72 i LPP-së-Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 43.5 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Neni 43.7 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1

AK ka shkel Nenin; 7 i LPP-se: Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

AK-ja ka shkelur këtë dispozitë në shumë raste duke na cilësuar neve si OE të papërgjegjshëm me arsye të paqëndrueshme e të cilat fare nuk pasqyrojnë realitetin në këtë tender.
Po ashtu autoriteti kontraktues ka përdorur standarde të dyfishta ndërmjet operatoreve ekonomik, ku për disa OE ofertues është munduar që të vërtetoj se a janë apo jo laboratorët të akredituar (siç është rasti me kompaninë nga Shqipëria IDK), ndërsa për Laboratorët tjerë siç janë testet e laboratorëve të OE Slloven KIG (Zag Slloven) AK-ja nuk ka shprehur interesim fare të vërtetoj faktin se a është i akredituar apo jo (i njëjti fakt vlen edhe për laboratorin e OE Rade Konqar për të cilin nuk ka asnjë dëshmi se ku është bërë testimi dhe tek cili laborator).
Faktin se autoriteti kontraktues e ka shkelur dispozitën e lartcekur duke përdorur standarde të dyfishta pasqyrohet edhe tek Raporti i forenzikës nr. AKF/2023-028 ku theksohet se Modeli i cili ekzaminohet me nr. 444 i ka 2 mangësi (Përpos trashësisë se materialit Bazë Aluminit) **1** është se forenzika thotë se ky OE **(EGO Elsa-Rade Koncar) SE** plotëson kushtin tek shenjat RKS në anën e majtë, Dëshmia nr. 4.1.
Ndërsa mangësia e dytë është se ky OE posedon nr. 8 shifror serik por jo sipas kërkesës së AK-së me shtypje Laserike Dëshmia 4.
Pikërisht ky fakt e tregon qartë se AK-ja nuk ka vepruar konform dispozitës së nenit 7, pasi që ka përdorur standarde të dyfishta ku nuk i ka marr parasysh fare faktet e pakontestueshme ashtu siç e cekëm edhe më lartë.

Ne dyshojmë se autoriteti kontraktues nuk i ka publikuar në tërësi dëshmitë e testimit të targave dhe test raportin për kërkesat tjera, për të gjithë operatorët ekonomik.

Pretendimi nr.2

Sa i përket arsyeve të eliminimit tonë, ju sqarojmë se të njëjtat arsye janë të paqëndrueshme për faktet si në vijim:
Në arsyen e parë të eliminimit tonë AK-ja e ka cekur se:

Dëshmia qe NUK keni ofruar:
1. Ju për këtë kërkesë keni prezantuar një test report nga MOTOR TRANSPORT INSTITUT me numër 1050/CBM/20222 datës 05.01.2023.
Ne aneksin 1 te dosjes se tenderit pika 10 përveç tjerave është kërkuar:

Alumin	Raport testues adresuar në prodhuesin e tabelës në pajtim me standardin ISO 7591 nga laboratori i akredituar.	Rezultati pozitivë në pajtim me ISO 7591 Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42, shtresa mbrapa aluminit të targës të jetë e mbrojtur me llak transparent.

Arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm për faktin se ne e kemi prezantuar Test Raportin i cili është i lëshuar nga një Laborator i Akredituar për testim sipas Standardit ISO 7591 Test raporti No. 1050/CBM/2022, konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Në të njëjtin raport, ceket shumë qartë tek faqja e dytë e raportit, se janë testuar dy pllaka alumini 520x112, përkatësisht tek dëshmia nr.1 të cilën edhe po ju bashkangjesim, shkruan se prodhuesi i këtij materiali është kompania e njohur gjermane **Novelis.** Në këtë raport theksohet qartë se rezultati i testimit sipas standardit ISO 7591 **ka qenë pozitiv,** ashtu siç është kërkuar tek kërkesa e dosjes së tenderit *"Raport testues adresuar në prodhuesin e tabelës në pajtim me standardin ISO 7591 nga laboratori i akredituar"*.

Pretendimi i AK-së se nuk ceket se ky alumin i ka karakteristikat e lartcekura, është i paqëndrueshëm ndërsa nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë të tillë është dashur të kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe natyrisht të na trajtojë në mënyrë të barabartë konform nenit 7 të LPP-së.
Pra, AK-ja ka mundur të vërteton shumë lehtë këtë çështje, kurse në dokumentet e prezantuara nga ne në ofertë përveç konfirmimit të prodhuesit të këtij materiali, ne kemi prezantuar edhe skemën teknike të prodhuesit, ku jo vetëm që ceken këto karakteristika por janë të theksuara qartë edhe shumë karakteristika tjera të këtij produkti, ashtu siç shihet edhe tek dëshmia me nr.1 të cilën po e bashkangjesim edhe me këtë

kërkesë për rishqyrtim.

Për të vërtetuar edhe më shumë faktet e lartcekura, të cilat i theksuam më lartë ne po ju bashkangjesim edhe dokumentin tjetër përkatësisht faturën e shitblerjes, dhe nga të gjitha këto fakte kuptohet qartë se arsyeja e lartcekur e eliminimit është e paqëndrueshme, pasi që ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Në lidhje me këtë arsye të eliminimit po ju bashkangjesim edhe sqarimin shtesë nga laboratori ku ceket si në vijim:

Applies: Test Report No. 1050/CBM/2022 of date 05.01.2023

Referring to the test report, we declare that the tested aluminum plates, 520x112, meet the requirements according to the Novelis technical data sheet. (Aluminum EN AW 1050 H42 or EN AW 1200 H42, the layer behind aluminum of the number plate to be protected with transparent varnish).

Bashkangjitur keni edhe kontratën për blerjen e aluminit.

Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit tonë, AK-ja e ka cekur se:

2. Nuk keni paraqitur – dorëzuar mostrat e targave në përputhshmëri me specifikimet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe sqarimeve te dt. 05.01.2023.

Komisioni i vlerësimit me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit lidhur me përshtatshmërinë teknike, duke u bazuar në raportin-ekspertizën e laboratorit të Forenzikës- me nr.Ref. AKF/2023-028 i dt. 28.02.2023, ka konstatuar se mostra me shifër (555) e dorëzuar nga ky ofertues nuk e përmbushin kërkesat sipas specifikimet teknike dhe sqarimeve te dt. 05.01.2023. te paraqitura gjeni ne tabelë me poshtë pikat te cilat nuk janë përmbushura për OE ne fjalë:

Kërkesa sipas specifikimit teknik ne dosjes se tenderit		Verifikimi i mostrës nga Laboratori i Forenzikës
1.Trashësia e Materialit Bazë	1 mm me tolerancë +-0.03	1.145mm

Konstatimi i lartcekur është i paqëndrueshëm, për faktin se kërkesë e qartë tek specifikimet teknike të detyrueshme ka qenë 1**. Materiali bazë-1.1 Alumin 1 mm i trashë Toleranca + / - 0.03mm,** dhe ne kemi ofertuar konform kësaj kërkese, mirëpo që AK-ja nuk e ka marr parasysh këtë fakt.

Ne si OE i përgjegjshëm kemi ofertuar konform specifikave teknike, mirëpo në këtë rast gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave kemi të bëjmë me devijim nga kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht devijim nga specifikimet teknike nga vet autoriteti kontraktues.
Faktin se ne kemi ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe se mostrat janë konform specifikimeve teknike mund të vërtetohet shumë lehtë nëse testohet materiali bazë i cili gjendet ne formë fizike tek AK-ja **-Dëshmia Nr.2 tek mostrat që ne i kemi dorëzuar me date 20.01.2023 në formë fizike.** Mirëpo AK-ja ka kërkuar nga Agjencioni i forenzikës qe të behet testimi i Modeleve të personalizuara (Gatshme) me 1. Materiali bazë 1.1 Alumin 1 mm i trashë Toleranca + / - 0.03mm + pika 2. Materiali Reflektues =1.15.

Prandaj duke pas parasysh qe kërkohet Materiali Reflektues nga prodhuesi 3M dhe pastaj të prodhohet modeli të cilin ne e dorëzojmë mirëpo në të njëjtën kohë nuk mund të shmangim faktin se materialit bazë i shtohet edhe Materiali Reflektues, ndërsa AK-ja këto fakte i di shumë mirë.

AK-ja ka kërkuar nga forenzika të bëj matjen e materialit bazë aluminit, mirëpo për çudi nuk i ka dërguar forenzikës materialin bazë (Vetëm aluminin), por i ka dërguar mostrën e personalizuar së bashku me folien reflektuese, e cila ka qenë kërkesë e veçantë në specifikime teknike, përkatësisht tek kërkesa nr.2- Materiali reflektues.

Në këtë rast Agjencia e Kosovës për Forenzikë, e cek shumë qartë se tek të gjithë operatorët ekonomik materiali bazë nuk mund të përcaktohet përbërja pasi nuk aplikohet kjo metodë e punës, shih Deshmija 3. Në këtë rast Forenzika me të drejtë e cek se nuk mund te aplikohet kjo metodë për faktin se materiali qe këta marrin për testim është targa e personalizuar se bashku me Materialin reflektues (i cili po ashtu ka trashësinë e saj, prandaj nuk mund dhe nuk duhet të anashkalohet përderisa e njëjta është pikë e veçante, sepse Pika 2 nuk është vazhdim i pikës 1 siç është paragrafi 1.1.)

Andaj këtu autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me vet kërkesat e saj të cilat i ka përcaktuar në dosje të tenderit. Kështu siç ka vepruar AK-ja i bie që të matet mostra e personalizuar (1.1 Alumini + 2. Materiali Reflektues/Folia 3M)TE Jet 1 mm i trashë Toleranca + / - 0.03mm është absurde sepse bie ne kundërshtim me vet kërkesën e AK-së.

Ne i kemi parashtruar AK-së edhe një pyetje se nëse ne si OE do te kishim sjellur aluminin e personalizuar shembull 0.80 qe kur te vendoset Materiali reflektues 0.20 dhe arrin ne 1.00mm, atëherë AK-ja do të na kishte shpallur tenderues të papërgjegjshëm pasi që është kërkuar materiali bazë alumini 1.00mm dhe ju keni sjell 0.80mm. Pasi që AK-ja ka dashur të bëj matjet e materialit bazë 1. Materiali bazë 1.1 Alumin 1 mm i trashë Toleranca + / - 0.03mm, atëherë lind pyetja pse nuk e ka merr materialin bazë që ne e kemi dorëzuar në mënyrë fizike Deshmija 2 dhe të bëj matjet vetëm të aluminit, ndërsa në qoftë se kjo matje nuk do te kishte dal 1.00mm do të ishte dashur ta pranonim faktin e tillë, ose ne qoftë se AK-ja e ka menduar që Mostra/Tabela Model te jetë 1,00mm pse nuk e ka përpiluar kërkesën në këtë mënyrë 1 . Materiali bazë 1.1 Alumin+ Materiali Reflektues 1.00mm me + / - 0.03mm

Pra në këtë rast sipas kërkesës së lartcekur është dashur të bëhet matja nga materiali bazë dhe jo materiali së bashku me materialin reflektues, pasi që në këtë mënyrë, po krijohet përshtypja se AK-ja qëllimisht e ka dërguar materialin bazë së bashku me materialin reflektues për matje.

Andaj duke u bazuar në këto fakte kuptohet qartë se ne kemi ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të specifikimeve teknike dhe njëkohësisht mostrat e prezantuara nga ne janë konform kërkesave të dosjes së tenderit, dhe kërkojmë nga OSHP-ja që të detyroni AK të merr materialin tonë Aluminin i cili është dorëzuar se bashku me Modelet dhe materialet tjera të pikës 10 të DT(Dëshmia 2) ta dërgoj ne Forenzikë dhe të bëj matjen e modelit tonë. Po ashtu duhet cekur se ne qoftë se merrni targat ekzistuese dhe bëni matjen edhe ato do dalin afërsisht me matje 1.15mm me tolerancë + / - 0.03mm.

Në rast se autoriteti kontraktues ka pasur dilema në lidhje me ndonjë nga dokumentet tona të prezantuara me ofertë atëherë ka mundur shumë lehtë të kërkoj sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues është dashur të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 ku është përcaktuar qartë *"2.Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve"*.

Gjithashtu faktin se AK-ja ka mundur të kërkoj sqarime shtesë, e parasheh edhe neni 72.2 ku shkruan se "*2.Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji"*.

Pretendimi 3

AK ka shkel Nenin 59 të LPP-se: Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Neni 40 Të rregullores Nr.001/2022 për prokurim publik Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe

AK-ja ka bërë shkeljen e nenit të lartcekur pasi që nuk ka bërë ekzaminim, vlerësim dhe krahasim të

tenderëve në mënyrë të njëjtë për të gjithë. Këtë pretendim e parashtrojmë pasi që vet AK-ja nuk ka vendosur të gjitha të metat e ofertave të operatorëve ekonomik të tjerë ofertues, përkatësisht tek OE GSG-KIG dhe OE EGO Elsa-Rade Koncar.

Pastaj tek OE GSG-KIG i njëjti është i papërgjegjshëm pasi që test raporti i OE GSG-KIG nuk e plotëson fare kërkesën sipas dosjes së tenderit, pasi që nuk është prezantuar fare MODELI që kërkohet.

Gjithashtu i njëjti ka mangësi edhe tek Pika 10 -Furnizuesi obligohet të bashkangjitë certifikata dhe dëshmitë që prodhuesi i targës i plotëson standardet e poshtëshënuara. I njëjti është i papërgjegjshëm pasi që nuk e plotëson pothuajse asnjë kërkesë sepse është bërë nga një Laborator i pa akredituar, e te cilin për çudi AK-ja nuk e ka marr fare mundin ta verifikoj një gjë të tillë siç ka bërë me OE të tjerë.

Pastaj tek OE **CETKOS-UTAL** njëjti është i papërgjegjshëm pasi Ky operator ekonomik ka prezantuar sigurimin e tenderit i cili është lëshuar nga Bank Polski nuk është konform kërkesave të dosjes së tenderit, ndërsa këtë pretendim tonin e vërteton edhe më shumë fakti se në tenderin e kaluar (2019) ka qenë pikërisht ky autoritet ndoshta edhe vet ky zyrtar prokurimi i cili neve na shpall të papërgjegjshëm me të vetmen arsye kinse ne nuk e plotësojmë këtë kusht administrativ.

Gjithashtu edhe për OE tjetër **EGO Elsa-Rade Koncar**, AK-ja nuk i ka vendosur të gjitha të metat e ofertës së kësaj kompanie në letrën standarde përkatësisht mangësitë te cilat shihen tek Raporti i forenzikës (Mostra me nr. 444 Dëshmia 4 dhe 4.1).

Po ashtu ne dyshojmë tek ky OE edhe sa i përket test raportit dhe Çertifikatës ISO 7591 për foljen e zezë që ky OE posedon. Këtë dyshim tonin e bën edhe më të fortë fakti që neve nuk na është dhënë ky raport që të mund ta shikojmë.

Ky veprim i AK-së është në kundërshtim edhe me nenin 10 të LPP-së sepse nuk na është dhënë qasje e plotë në dokumentet e kompanive ofertuese. Me këtë rast nuk është respektuar edhe neni 11 i LPP-së sepse është dashur të përgatitet versioni i pastruar.

Përderisa nuk na është dhënë ky raport i OE dhe faktet e Forenzikës se Kosovës, neve na shtohen dyshimet se për të njëjtin OE ekzistojnë edhe fakte tjera të cilat i njëjti nuk i plotëson kërkesat;

Pretendimi 4

AK ka shkel Neni 60 LLP-se Kriteret për Dhënien e Kontratës

AK-ja nuk e ka respektuar nenin e lartcekur përkatësisht paragrafin 1.1 ku përcaktohet qartë se AK-ja do ta rekomandoj për kontratë tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

Duke pasur parasysh faktin se nëse AK-ja do të kishte përfillur nenet e sipërpërmendura ne do te kishim qenë OE i vetëm i përgjegjshëm dhe do te ishte dashur qe ne të shpallemi fitues, andaj mos respektimi i neneve të lartcekura na diskriminon neve si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Pretendimi 5

AK ka shkel Neni 69 LLP-se: Aftësia teknike dhe profesionale.

AK-ja nuk i ka respektuar dispozitat e nenit të lartcekur përkatësisht paragrafit 2.4- mostrave të produktit, përshkrimeve, siç e kemi cekur me lart tek pretendimi i jonë, **AK-ja nuk i është përmbajtur kërkesave të saj sa i përket Mostrës te cilën e ka kërkuar**.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kërkesa ka qenë Një mostër të targës me dimensione 520 x 110mm, sipas specifikimeve teknike, andaj AK-ja duke na shpallur neve të papërgjegjshëm kinse nuk e plotësojmë kërkesën sipas Pikës 2.4 gjegjësisht mostrës qe prezantojmë, ky pretendim nuk qëndron fare.

Po ashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe dispozitën e nenit 69 të përkatësisht paragrafit 2.5 certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuara që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet

dhe standardet përkatëse. AK-ja nuk i ka pranuar Certifikatat tona, pastaj test raportet tona dhe duke na etiketuar si të papërgjegjshëm (Pa vërtetuar dhe pa marr parasysh shkresat të cilat janë prezente dhe të njëjtat po ju bashkangjesim edhe një herë me kërkesë për rishqyrtim).
AK-ja nuk e ka shfrytëzuar fare mundësinë e vërtetimit të Organizatave /institucioneve që a janë apo jo këto Agjenci të pranuara/akredituara.

Në këtë rast OE Test raportet e OE **GSG-KIG Lëshuar nga Laboratori ZAG i cili sipas neve nuk është i akredituar dhe i cili shumë lehtë do të vërtetohej në qoftë se AK-ja do të i ishte drejtuar Zyrave te Akreditimit Slloven, siç kemi vepruar ne si OE ne vitin 2020 dhe kemi marr këtë përgjigje nga akreditimi Slloven.**

Deshmija Nr 5

SLOVENSKA AKREDITACIJA

Šmartinska cesta 152
SI-1000 Ljubljana
T +386 (0)1 547 32 50
F +386 (0)1 547 32 72
http://www.slo-akreditacija.si

i.A. Marksim Malsijaj
EHA
Hoffmann International GmbH
Deutchland

Datum: 24. 1. 2020

Dear Sir

With the reference to your question we have to inform you that we haven't granted any accreditations **according to the standard ISO 7591/1982.**

We have granted accreditation for retro reflection for floor markings and traffic signs according to the standards SIST EN 1436:2007 i EN 12899-1 to the following conformity assessment bodies:

- Zavod za gradbeništvo http://www.slo-akreditacija.si/acreditation/zavod-za-gradbenistvo-slovenije/
- Neks http://www.slo-akreditacija.si/acreditation/neks-druzba-za-inzeniring-meritve-in-prometno-signalizacijo-d-o-o/
- Igmat http://www.slo-akreditacija.si/acreditation/igmat-institut-za-gradbene-materiale-d-d/

Please check the scope of accreditation for above mentioned CAB's on our website (the links which we have provided above). The annex to the accreditation certificate clearly states the standards for which the conformity assessment bodies are accredited.

Kind regards,

dr. Bošljan Godec,
director

Përderisa ju nuk keni kërkuar informacione apo nuk jeni interesuar edhe për laboratorët e OE tjerë se a janë te akredituar sipas standardit ISO 7591, atëherë kuptohet se këto veprime bëhen me qëllime të caktuara.

DESHMITË tona që ky laborator nuk është i akredituar DHE adresa ku mund të merrni informacione po ja bashkëngjisim kësaj kërkese për rishqyrtim.

Po ashtu të njëjtat pretendime i kemi edhe për Institucionin që ka bërë certifikimin dhe lëshuar test raportin e OE EGO Elsa-Rade Koncar

Grupi i operatorëve ekonomik Eich Utsch AG; Horn & Co Kosova SHPK, janë të papërgjegjshëm për faktin se nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, ku kërkesë ka qenë *"Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet te dëshmoj që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është

kërkuar *"3. Dëshmi e lëshuar nga laboratori apo instituti i autorizuar (kopje), AK rezervon te drejtën qe te kërkoi origjinalin e dokumentit me nëse e konsideron te nevojshme)"*.

Ky grup i operatorëve ekonomik nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se ashtu siç ka konstatuar edhe autoriteti kontraktues, në test raportin e prezantuar nga i njëjti nuk figuron që janë bërë matjet për mostrën 01-999-AD, ashtu siç është specifikuar në dosje të tenderit. Ky operator ekonomik ka prezantuar një Specifikacion teknik nga KURZ, ndërsa vet AK-ja e ka cekur se nuk posedon asnjë dëshmi që KURZ është Laborator apo institut i akredituar për matje, ashtu siç është specifikuar në kërkesën e lartcekur.

Andaj si i tillë ky grup i operatorëve ekonomik është i papërgjegjshëm.

Operatori ekonomik "EUROPRINTY", i cili ka ofertuar me çmim më të lirë se sa ne është i papërgjegjshëm, për faktin se i njëjti nuk ka ofertuar në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit.

Ashtu siç e ka specifikuar edhe AK-ja në letrën standarde për tenderues të eliminuar ky operator ekonomik nuk ka ofruar fare sigurimin e tenderit, dëshmi kjo që është obligative të përmbushet. Gjithashtu i njëjti OE nuk ka prezantuar mostër të targës fare, ashtu siç edhe është kërkuar në dosje të tenderit dhe si i tillë i njëjti është i papërgjegjshëm dhe ne pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin e të njëjtit OE.

Operatori ekonomik tjetër i cili ka ofertuar me çmim më të lirë se sa ne **OE "IDK KONSTRUKSION SHPK",** po ashtu është i papërgjegjshëm sepse nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, përkatësisht kërkesën me nr.3 tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale. Kërkesë e qartë e dosjes së tenderit ka qenë *"Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet te dëshmoj që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"3. Dëshmi e lëshuar nga laboratori apo instituti i autorizuar (kopje), AK rezervon te drejtën qe te kërkoi origjinalin e dokumentit me nëse e konsideron te nevojshme)"*.

OE "IDK KONSTRUKSION SHPK", nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, pasi që ashtu siç e ka specifikuar edhe AK-ja në arsyen e eliminimit për të njëjtin, ky OE ka prezantuar një test raport me nr. AQS/12122022, ku edhe janë kryer testimet. AQSCERT-SHPK nuk është i akredituar për ISO 7591, ashtu siç është specifikuar në kërkesë dhe si i tillë test raporti është i pavlefshëm.
Një fakt të tillë e ka vërtetuar edhe vet autoriteti kontraktues në letrën standarde për tenderues të eliminuar.

Operatori ekonomik tjetër me çmim më të lirë se sa ne **OE "CETKOS L.L.C; Utal Spz.o.o",** është po ashtu i papërgjegjshëm, për faktin se edhe ky operator nuk e ka plotësuar kërkesën në lidhje me Test raportin nga laboratori apo instituti i autorizuar.
I njëjti OE nuk e plotëson kërkesën nr.3 tek kapaciteti teknik dhe profesional sa i përket test raportit, për faktin se ashtu siç ka konstatuar edhe AK-ja nga test raporti i prezantuar nga i njëjti nuk figuron askund që i njëjti OE ka bërë matjet për mostrën 01-999-Ad, ashtu siç është specifikuar në dosje të tenderit.

Po ashtu në test raportin e prezantuar nga i njëjti nuk figurojnë rezultatet pozitive sipas kërkesës nr.10 tek aneksi 1 i dosjes së tenderit.

Andaj ne pajtohemi me arsyen e lartcekur të AK-së, për eliminimin e operatorit ekonomik të lartcekur.

Grupi i OE "G.S.G SH.P.K; KIG d.d", po ashtu janë të papërgjegjshëm për faktin se të njëjtit nuk e kanë dorëzuar mostrën sipas dizajnit grafik 01 999 AD, sipas kërkesës së AK-së. Këtë fakt e ka vërtetuar edhe vet AK-ja në arsyen e dhënë për eliminimin e të njëjtit në letrën standarde për tenderues të eliminuar.

Po ashtu i njëjti grup është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën në lidhje me test raportin nga laboratori apo instituti i autorizuar. I njëjti në lidhje me këtë kërkesë ka prezantuar një test raport të vitit 2018 i cili nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Ne me dt.21.03.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ku AK-ja e ka cekur se e njëjta është e pa bazuar mirëpo nuk ka dhënë ndonjë arsyetim konkret në lidhje me refuzimin e saj.

Në lidhje me pretendimet tona ankimore për mosrespektimin e nenit 7 të LPP-së për shkak se janë përdorur së standardeve të dyfishta, AK-ja e ka cekur se nuk qëndron ky pretendim ankimor por që nuk ka dhënë ndonjë arsye konkrete për këtë arsyetim të saj edhe pse nga faktet e prezantuara në kërkesën për rishqyrtim dhe tani në ankesë vërtetohet se pretendimet tona janë të bazuara.

Sa i përket pretendimit tjetër ankimor ku ne e kemi cekur se *"për disa OE ofertues ju jeni munduar që të vërtetoni se a janë apo jo laboratorët të akredituar (siç është rasti me kompaninë nga Shqipëria IDK), ndërsa për Laboratorët tjerë siç janë testet e laboratorëve të OE Slloven KIG (Zag Slloven) nuk keni shprehur interesim fare të vërtetoni faktin se a është i akredituar apo jo (i njëjti fakt vlen edhe për laboratorin e OE Rade Konqar për të cilin nuk ka asnjë dëshmi se ku është bërë testimi dhe tek cili laborator)*", AK-ja e ka cekur se nuk qëndron pretendimi ynë për faktin se dy ofertuesit kanë dorëzuar teste nga laboratori DEKRA Gjermani dhe dëshmi të akreditimit.
Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se në dokumentet në të cilat ne kemi pasur qasje për OE të lartcekur nuk kemi hasur në ndonjë dëshmi të tillë, andaj edhe arsyetimi i AK-së është i pa bazuar. Gjithashtu një dëshmi të tillë AK-ja edhe me rastin e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nuk e ka prezantuar ndonjë dokument që e vërteton të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.
Gjithashtu kur analizohet raporti i vlerësimit, tek kërkesa në lidhje me test raportet komisioni për OE Ego Elsa & Rade Koncar është konstatuar si në vijim:

3. Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet te dëshmoj që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim te automjeteve dhe karakteristikat teknike te targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike te dosjes se tenderit.	I papajtueshëm

Pra nga konstatimi i lartcekur i komisionit vlerësues figuron se OE i lartcekur nuk ka ofertuar në pajtim më kërkesën për test raport nga laboratori.

Ndërsa në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket mostrës së dorëzuar nga OE Ego Elsa & Rade Koncar AK-ja është arsyetuar si në vijim:

Gjitashut pretendimi se se Grupi i Operatorve ekonomik Ego Elsa & Rade Koncare nuk plotson kerkesat tek mostra e dorzuar te pjesa e RKS dhe numrit serik , nuk qendron sepse ne mostren e dorzuar shihet se i njejti posedon shenjen RKS ne forme periodike dhe gjithashu posedon numrin serik sipas kerkesave ne specifikimin teknik pika 9 te dosjes se tenderit, ku nuk eshte specifikuar forma laserike apo mekanike e numrit 8 shifror, andaj keto pretendime jane **tërsishte te pa bazuara** dhe AK-MPB ka vepruar ne harmoni me neni 7 dhe 59 te LPP-se.

Arsyetimi i lartcekur i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm për faktin se pretendimi ynë është parashtruar duke u bazuar në raportin e forenzikës me nr. AKF/2023-028 ku theksohet se Modeli i cili ekzaminohet me nr. 444 i ka 2 mangësi (Përpos trashësisë se materialit Bazë Aluminit) 1 është edhe fakti se forenzika e thekson se OE EGO Elsa-Rade Koncar **SE** plotëson kushtin tek shenjat RKS ne anën e majtë, **Dëshmia nr. 4.1.**

Pra pretendimi i lartcekur është bërë duke u bazuar tek raporti i forenzikës, ku vërtetohet se pretendimi ynë ankimor është i bazuar, andaj arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm.

Ndërsa në lidhje me pretendimin tjetër ku e kemi cekur se mangësia e dytë është se ky OE posedon nr. 8 shifror serik por jo sipas kërkesës tuaj me shtypje Laserike, AK-ja e ka cekur se nuk është specifikuar forma Laserike apo mekanike. Arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se tek raporti i forenzikës shkruan qartë se i njëjti OE posedon numër serik me gjithsej 8 numra dhe barkodi nuk është me shtypje Laserike. Ndërsa në kërkesë shkruan se **numrin serik dhe barkodin të gdhendur me laser ose mekanike.**

Andaj nga ky fakt kuptohet se arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm. I njëjti OE dyshojmë që kodin 8 shifror nuk e posedon me asnjërën nga metodat e lejuara (të gdhendur me laser ose mekanike), por e ka me metodën sitoshtypje, ndërsa kjo metodë nuk ka qenë e lejuar në kërkesën e lartcekur, andaj si i tillë ky OE është i papërgjegjshëm edhe për këtë fakt.

Autoriteti kontraktues me rastin e shqyrtimit të kërkesës tonë për rishqyrtim nuk ka dhënë përgjigjje në të gjitha pretendimet tona ankimore duke na diskriminuar neve si OE të përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht është munduar të devijoj edhe nga pretendimet tonë ankimore kundrejt OE të lartcekur.
Tek dëshmia që po e bashkangjesim me këtë ankesë Dëshmia 4.1 shihet qartë se raporti i forenzikës e cek se ne anën e majtë nuk pasqyrohet imazhi Numerik I RKS. Dëshmia siç është kërkuar është si më poshtë:

Këtë pozicion OE EGO-Elsa& Rade KONCAR nuk e plotëson, mirëpo edhe pse forenzika e vërteton faktin se ky OE nuk e plotëson kërkesën dhe një pretendim të tillë e kemi parashtruar edhe ne, i njëjti pretendim nuk merret parasysh nga ana e AK-së edhe pse pretendimi ynë është i bazuar dhe vërtetuar me fakte konkrete. (Analizojini dëshmitë e bashkangjitura në ankesë).

I njëjti OE (EGO-Elsa& Rade KONCAR) tek kërkesa ku është specifikuar targa e automjetit **Specifikimi detal për furnizim me targa të Republikës së Kosovës** **(4.1** Shiritat me ngjyrë të zezë për shkronja dhe numra, detyrimisht duhet të kenë shenjen RKS të përsëritur periodikisht në të gjithë gjatësinë dhe gjerësinë e tyre . Orientimi i shenjës RKS do të bëhet në linjën, në këndin 45 shkallë me konturat e shiritit në distancë 4.0 mm dhe 5.5 mm nga njëra tjetra), ne kemi dyshimet tona qe ky OE nuk e posedon fare këtë produkt mirëpo sipas dyshimeve tona, i njëjti vetëm për ta plotësuar këtë kërkesë Modelin e kërkuar e ka bërë me anë të sitoshtypjes dhe e ka mbuluar me adeziv mbrojtës. Ndërsa nga ky fakt kuptohet se i njëjti OE nuk e plotëson edhe këtë kërkesë. Nëse eventualisht do të vinte deri te kërkesa për ekzekutim të projektit atëherë ky projekt do të dështonte. Andaj ne kërkojmë që me rastin e mbajtjes së seancës në OSHP të sjellet mostra e dorëzuar nga ky OE.

AK-ja na ka diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit edhe me vet faktin se nuk na ka lejuar qasje të plotë në dokumentacionin e OE të lartcekur, përkatësisht nuk na ka lejuar qasje në test raportin teknik dhe certifikatat e të njëjtit me arsyetimin se të njëjtat dokumente janë cilësuar si sekret afarist nga OE. Andaj me këtë rast nuk është respektuar neni 10 dhe 11 i LPP-së në lidhje me qasjen në dokumentet e OE të lartcekur.

Përveç këtyre shkeljeve që ka bërë AK-ja, e njëjta ka ngritur pretendime të pa qena dhe na eliminon neve me një arsyetim se kinse ne nuk i plotësojmë kushtet e kërkuara tek kërkesa e pikës 10. AK-ja me këtë rast devijon nga kërkesa e dosjes së tenderit të cilën vet ajo e ka përcaktuar tek pika 10.

10.Furnizuesi obligohet të bashkangjitë certifikata dhe dëshmitë që prodhuesi i targës i plotëson standardet e poshtëshënuara.

Materiali që kërkohet	Dokumenti që kërkohet	Kërkesa

Shtresë me stampim të nxehtë	Certifikata dhe test raporti i adresuar në prodhuesin e tabelës së regjistrimit në pajtim me standardet ISO 7591 i lëshuar nga një laborator i akredituar.	Shtresë me stampim të nxehtë në pajtim me fletën retroreflektive dhe të dyja në pajtim me ISO 7591, pjesa 8, 12, 13, 14 dhe 15.

Këtu shihen standardet e dyfishta të cilat AK-ja i ka përdorur, pasi që e njëjtë nuk e merr mundohet fare që këtë OE dhe OE të tjerë ti kontrolloj se a plotësojnë këtë kërkesë, pra të verifikoj se a e posedojnë Certifikatën dhe test raportin ISO 7591 për këtë produkt (Shtresë me stampim të nxehtë).
AK me rastin e pyetjeve përgjigjeve nga OE e ka larguar këtë certifikata- *Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Pika 9,1-9.2 në Piken 6.Operatori ekonomik duhet të ofrojë Certifikatën valide ISO Standard 7591 për prodhimin e targave retro-reflektive për automjete motorike dhe rimorkio (Retro-reflective registration plates for motor vehicles and trailers).* Këtë kërkesë AK-ja e ka larguar përmes pyetjeve sqaruese, certifikatën sa i përket targave Retro-reflektive. Për ne largimi i kësaj kërkese nga dosja e tenderit ka qenë dyshuese, pasi që e njëjta është një certifikatë e cila tregon se kompanitë që e posedojnë këtë certifikatë, i plotësojnë gjitha kërkesat që kërkohen sipas këtij standardi dhe plotësojnë kualitetin qe kërkohet. Dyshimi ynë tani po forcohet edhe më shumë pasi që mendojmë se largimi i kësaj kërkese është bërë për favorizimin e disa OE që nuk e posedojnë këtë certifikatë.
Mirëpo pasi që kërkesa që OE ta posedojnë këtë certifikatë edhe për shtresë me stampim të nxehtë si tek kërkesa Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9,1-9.2 pika 5 e specifikacionet teknike Pika 10 ka mbetur si kërkesë e dosjes së tenderit, atëherë është dashur të respektohet gjatë vlerësimit dhe të jipet përgjigjje në kërkesën për rishqyrtim. Pra AK-ja edhe në përgjigjje të kërkesës për rishqyrtim nuk e ka cekur faktin se ky OE dhe shumë të tjerë nuk e posedojnë këtë Certifikatë.

Andaj kërkojmë nga Eksperti i OSHP dhe vet OSHP ta analizojnë dhe shqyrtojnë këtë pretendim tonin ankimor si për OE EGO-Elsa& Rade KONCAR dhe OE të tjerë, se a e posedojnë certifikatën e kërkuar.

Në lidhje me pretendimin tonë ankimor për arsyen e parë të eliminimit, AK-ja ka dhënë përsëri arsyen e njëjtë sikurse me rastin e eliminimit tonë, pra vetëm ka përsëritur arsyen e njëjtë pasi që nuk ka pasur argumente të mjaftueshme për të kundërshtuar pretendimin tonë ankimor. E njëjta në arsyetimin e saj e cek përsëri se në testin e laboratorit nuk ka dëshmi të evidencës së testimit dhe rezultat pozitiv në pajtim me ISO 7591 për Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42, mirëpo ne me kërkesë për rishqyrtim e kemi bashkangjitur përsëri dëshminë tonë të test raportit ku ceket shumë **qartë tek faqja e dytë e raportit**, se janë testuar dy pllaka alumini 520x112, përkatësisht tek dëshmia nr.1 të cilën edhe po ju bashkangjesim, shkruan se prodhuesi i këtij materiali është kompania e njohur **gjermane Novelis**. **Në këtë raport theksohet qartë se rezultati i testimit sipas standardit ISO 7591 ka qenë pozitiv**, ashtu siç është kërkuar tek kërkesa e dosjes së tenderit "Raport testues adresuar në prodhuesin e tabelës në pajtim me standardin ISO 7591 nga laboratori i akredituar". Në lidhje me arsyen e lartcekur të AK-së ne i kemi prezantuar si dëshmi me kërkesë për rishqyrtim edhe sqarimin shtesë nga laboratori dhe kontratën për blerjen e aluminit.
AK-ja nuk e ki marr parasysh fare këto fakte mirëpo vetëm ka përsëritur arsyetimin e njëjtë dhe gjithashtu nuk e ka marr parasysh fare edhe pretendimin tonë se në rast të ndonjë dileme e njëjta ka mundur të kërkoj sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Në lidhje me pretendimin tjetër ankimor sa i përket trashësisë së mostrës për të cilën arsye ne jemi eliminuar, AK-ja nuk ka dhënë ndonjë përgjigjje mirëpo vetëm e ka bashkangjitur arsyen e eliminimit tek letra standarde që na është dërguar. Përderisa AK-ja nuk ka dhënë ndonjë arsyetim në lidhje me pretendimin tonë, atëherë nga ky fakt kuptohet se e njëjta nuk ka mundur ta kundërshtoj pretendimin tonë ankimor me fakte konkrete dhe si përfundim kuptohet se pretendimi ynë është i qëndrueshëm.

E njëjta në vendimin për refuzim e ka cekur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se nuk janë respektuar dispozitat e neneve 60, 62 të LPP-së dhe nenit 43.5 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik dhe i është referuar dispozitës së nenit 62 paragrafi 1.1 për anulimin e procedurës.
Arsyetimi i lartcekur i AK-së nuk qëndron pasi që referimi ynë në dispozitat e lartcekura është i qëndrueshëm sepse në këtë aktivitet të prokurimit ne jemi OE i përgjegjshëm dhe anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Veprimet e AK-së për të anuluar këtë aktivitet të prokurimit bien ndesh me nenin 62 të LPP-së, pasi që nuk janë plotësuar kushtet për anulim të tenderit.

Gjithashtu ky anulim i këtij aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenet 43.5 dhe 43.7 të Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë.

Andaj ne përmes kësaj kërkese për rishqyrtim kërkojmë që të detyroni AK të i shqyrtojë pretendimet tona ankimore dhe ti verifikon edhe këta laboratorë siç ka bërë edhe me OE të tjerë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të:

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE TSR SH.P.K si dhe të
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM,
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e supozuara kane shkaktuar dëmtim te imazhit te kompanisë kur kihet parasysh afarizmi jone ne tregun global. Gjithashtu na është shkaktuar dem material-financiar. Shpenzimet për teste, shpenzimet e udhëtimit nga Gjermani ne Kosove, Noterizimi i dokumenteve, punimi i cilindrit dhe foljes se nxehtë për shtampim RKS e cila ka kushtuar 30.000 euro. Demi në vlerë financiare llogaritet mbi 50,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*